

Gjykatat e Grave - Përvojat ndërkombëtare

Për punën e Gjykatave të Grave,
Qëllimeve dhe rezultateve të
gjykatave të grave

Çka janë Gjykatat e Grave?

Gjykata e gruas është hapësirë për votat e grave, për dëshmimin e grave lidhur me përvojat e përditshme të padrejtësive të përjetuara gjatë luftës dhe në paqe; në gjykatën e Gruas, gratë dëshmojnë për dhunën në sferën private dhe publike, si dhe për rezistencën e organizuar të grave.



Kur kane filluar se punuari Gjykatat e grave?

Gjykata e pare e Gruas është organizuar në vitin 1992 në La Hore, Pakistan. Deri më sot, kanë organizuar rreth dyzet Gjykata të grave në botë, e më së shumti në Azi dhe Afrikë.

Me çka merren Gjykatat e Grave?

Krimet e luftës ndaj grave: zhvendosja e dhunshme, pastrimi etnik, trafikimi i grave, krimet seksuale (përdhunime në luftime, prostitucioni i dhunshëm, shtatzënia e dhunshme, skllavëri seksuale), etj.

Dhuna ushtarake ndaj gruas dhe ndaj tërë popullatës: Të gjitha llojet e armeve (konvencionale, nukleare, helmet e ngjyroshme), Industria e seksit rreth shtëpive ushtarake; tortura, bllokadat ekonomike ndaj civilëve, etj.

Dhuna dhe krimet ndaj gruas në emër të ligjit dhe religjionit: gjymtimi gjenital, gjuajtje me gurë në gratë; imponimi i kodit të veshjes (dress code); diskriminim ndaj grave në aspektin e marrëdhënies pronësore, martesat me marrëveshje, fetidic – vrasja e fetusit të gruas, etj.

Dhuna ekonomike, shkelje të të drejtave të punës së grave: shfrytëzimi në vendin e punës, diskriminimi gjatë punësimit, feminizmi i varfërisë, etj.

Dhuna ndaj grave në familje: dhuna fizike, psikologjike, dhuna seksuale.

Dhuna politike: arrestimet e paligjshme, tortura, rrëmbimi, persekutime, frikësime, burgjet shtëpiake, etj.

Abuzimet e të drejtave riprodiktive të grave, mohimi i kontracepsionit dhe ndalimi i abortit, sterilizimi i detyruar, abuzimi i trupave për eksperimente mjekësore, etj.

Rezistenca e gruas: kundër të gjitha formave të padrejtësisë patriarkale në sferën private dhe publike.

Cilat janë arritjet dhe rezultatet e Gjykatave të Grave?

👁️ *Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe dhuna kundër gruas:* gjinore dhe strukturore (social-ekonomike, politike, ushtarake, përhershme, etj) cila nuk është njohur e as sanksionuar në bazë të sistemit ligjor ekzistues;

👁️ *Përforcimi i shoqërisë civile në planin lokal, regjional dhe global:* krijimi i koalicionit solidar të organizatave të shoqërisë civile (aktivistja, gruaja nga komuniteti akademik dhe artistik) Përforcimi i aktivizmit feminist dhe lëvizjes feministe;

👁️ *Gjykatat e Grave janë të inkurajuara për të punuar së bashku,* për solidaritetin dhe përkrahjen reciproke të grave në çdo vend ku janë organizuar;

👁️ *Gjykatat e grave kritikojnë, apelojnë, e sfidojnë shtetin, por mbi të gjitha promovojnë konceptin e ndryshëm të së drejtës:* Gjykatat e grave nuk mund të jenen 'shërbim' i shtetit por gjithë kanë autonomi ndaj shtetit, kombit, ushtrisë, kishës, partisë...

👁️ *Presioni mbi sistemin ligjor institucional – sistem – inicimi i iniciativave legjislativë në planin lokal, regjional dhe global,* si para parlamentit kombëtar ashtu edhe para

Kombeve të bashkuara, institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë;

- 👁️ *Krijimi i vizioneve të ndryshme/alternative të drejtësisë dhe të paqes: nga pikëpamja e grave dhe grupeve të shtypura shoqërore, dhe si përgjigje ndaj karakterit patriarkal dhe mosndëshkimit të dhunës në kuadër të sistemeve ligjore ekzistuese;*
- 👁️ *Gjykatat e Grave zhvillojnë etiken feministe të përgjegjësisë dhe kujdesit: Gjykatat e grave inkurajojnë shqetësimin për të tjerët dhe për vetën e tyre, drejt krijimit të një bote më të drejtë;*
- 👁️ *Gjykatat e Grave inkurajojnë krijimin e praktikës gjyqësore të bazuar në kontekstin dhe realitetin e përditshëm: Gjykatat e Grave nxisin krijimin e praktikës gjyqësore dhe ligjit (nga pikëpamja e shoqërisë civile dhe lëvizjeve shoqërore);*
- 👁️ *Krijimi i institucioneve alternative të drejtësisë nga ana e gruas: mobilizimi i institucioneve lokale dhe regjionale (më së shpeshti të gjykatave të gruas, komisioneve të gruas- Të përhershëm dhe të përkohshëm);*
- 👁️ *Nisja e përbashkët e fushatave ndërkombëtare: kundër luftës, militarizmit, racizmit, ligjeve mizore të tregut dhe ekonomisë jo*

liberale, të gjitha format e fundamentalizmit, rritjes së varfërisë së gruas, etj.

- 👁️ *Forcimi i rrjetit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut: janë krijuar aleanca të forta të avokateve të cilat drejtojnë fushatat lokale, regjionale dhe ndërkombëtare me qëllim të mbrojtjes direkte të grave nga të gjitha format e dhunës;*
- 👁️ *Dukshmëria e kulturave dhe komuniteteve të marginalizuara: Trashëgimia e diversitetit dhe të popujve indigjene paqësor; dialog në mes të grave të kulturave të ndryshme...*

„Gjykatat e Grave janë hapësirë alternative politike - horizont që na fton të ndjejmë, mendojmë, sfidojmë, të lidhemi dhe të veprojmë, ëndërrojmë së bashku...”

(Korin Kumar, India)

Gratë në të Zeza
Jug bogdanova 18/5, Beograd
+381 11 26 23 225
zeneucrn@gmail.com
www.zeneucrn.com



**mama
cash**

Zbatuar me ndihmën financiare
Mama Cash



GJYKATA E GRAVE

Përvojat ndërkombëtare